



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Horn and Co. Analytics" Sh.P.K. të datës 13.02.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-40-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Horn and Co. Analytics" Sh.P.K. të datës 13.02.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet - Ritender" me nr. të prok. 616-26-40-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Horn and Co. Analytics" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 13.02.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale" me nr. të prokurimit 616-25-1179-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

1. Pretendimi ankimor sa i përket: **Aplikimit të metodës së analizimit të Azbesitit, me metodën Metoda PLM (NIOSH 9002) të Aneksit 1 të DT**

Metoda PLM (NIOSH 9002) ka një limit zbulimi praktik rreth 1% (m/m) dhe nuk siguron ndjeshmërinë e nevojshme për identifikimin e gjurmëve të azbestit që mund të mbeten pas procesit të largimit ose trajtimit (Demolimit, Ambalzhimit dhe Transportimit të materialeve me përmbajtje azbesti nga objektet e specifikuar ne Dosjen e Tenderit-DT). Për rrjedhojë, metoda PLM (NIOSH 9002) konsiderohet e papërshtatshme për këtë qëllim, krahasuar me metoda më të avancuara analitike që ofrojnë ndjeshmëri dhe saktësi më të lartë.

2. Propozimi për aplikimin e metodës: **SEM-EDX (Scanning Electron Microscopy with Energy Dispersive X-ray Analysis)**

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet sqaruar se parashtruesi nuk kërkon largimin e metodës PLM NIOSH 9002 sipas aneksit 1 mirëpo ka kërkuar zëvendësimin e kësaj metode me metodën tjetër SEM-EDX. Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur specifikimet teknike. Në rastin konkret njësia kërkuese ka përcaktuar metodën e analizimit në përputhje me nevojat, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Ndryshimi i kësaj metode jo vetëm që është e panevojshme por edhe praktikisht e pamundur sepse largimi apo ndryshimi i kësaj metode mund të cenoj efikasitetin dhe efektivitetin e realizimit të projektit në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 19.02.2026



Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.